VENDIM
Nr. 4, datë 16.10.2026

PËR DIGJITALIZIMIN DHE NGARKIMIN E DOKUMENTACIONIT TË DIGJITALIZUAR NË SISTEMIN E ARKIVIT TË PËRQENDRUAR DIGJITAL

Në mbështetje të nenit 9, nenit 40, pika 1, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat", të ndryshuar, dhe të nenit 10, pika 5, të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe të organeve që funksionojnë pranë saj", miratuar me vendimin nr. 821, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Këshilli i Lartë i Arkivave

VENDOSI:

1. Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, si dhe autoritetet e tjera publike, pjesë e Rrjetit Arkivor të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të organizojnë digjitalizimin e dokumentacionit që administrojnë dhe ngarkimin e tij në sistemin e arkivit të përqendruar digjital, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Digjitalizimi i dokumentacionit shkresor realizohet duke siguruar riprodhimin e plotë, të qartë dhe besnik të origjinalit, përfshirë të gjitha faqet dhe elementet përbërëse të dokumentit. Përpara ngarkimit në sistem, institucioni verifikon plotësinë dhe cilësinë e kopjes digjitale.
3. Dokumentet ngarkohen në sistem duke ruajtur organizimin e tyre sipas institucionit fondkrijues, dosjeve dhe njësive arkivore përkatëse, si dhe lidhjet ndërmjet dokumenteve të së njëjtës praktikë. Ngarkimi kryhet sipas formateve dhe fushave identifikuese të përcaktuara në udhëzimet teknike të përdorimit të sistemit.
4. Titullari i çdo institucioni cakton punonjësit përgjegjës për organizimin e digjitalizimit, verifikimin dhe ngarkimin e dokumentacionit në sistem. Institucioni i komunikon DPA-së personat e autorizuar për përdorimin e sistemit dhe njofton ndryshimet e tyre.
5. Nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, çdo dokument shkresor, hyrës, dalës apo i brendshëm, skanohet dhe ngarkohet në sistemin e arkivit të përqendruar digjital, pas regjistrimit dhe përfundimit të procedurave përkatëse të nënshkrimit dhe vulosjes, sipas rastit. Ky detyrim zbatohet në mënyrë të vazhdueshme, krahas digjitalizimit dhe ngarkimit në sistem të dokumentacionit të periudhave të mëparshme, që ruhet në arkivin e institucionit.

6. Institucionet përgjigjen për saktësinë, plotësinë dhe përputhjen e dokumenteve të ngarkuara në sistem me dokumentacionin që administrojnë. Gabimet e evidentuara korrigjohen në mënyrë të gjurmueshme, duke ruajtur historikun e veprimeve sipas funksioneve të sistemit.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në kuadër të administrimit të sistemit në bashkëpunim me AKSHI-n, u siguron institucioneve udhëzimet e përdorimit dhe ndihmën metodologjike për zbatimin e këtij vendimi.

8. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe të gjitha institucionet e përcaktuara në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I ARKIVAVE
Auron Rrokaj